



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA KLINË
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA
05 Nr.No. 401-24800/23
Data-Date-Datum: 27.07.2023
Klinë-Klina

RAPORTI NGA PROCESI I ORGANIZIMIT TË DËGJIMEVE BUXHETORE PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE 2024-2026

Qershor, 2023

HYRJE

Korniza afatmesme buxhetore komunale paraqet një përmbledhje të planifikuar të shpenzimeve dhe të hyrave buxhetore për komunën e Klinës, për periudhën afatmesme 2024-2026, si dhe shpërndarjen e resurseve financiare nëpër programe komunale sipas prioriteteve të qeverisë komunale, të nxjerra nga dokumentet strategjike komunale dhe vendimet e Kuvendit komunal të Klinës.

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) që po prezantojmë është një dokument i cili përgatitet nga administrata komunale dhe miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen e objektivave prioritare, të identifikuara në dokumentet strategjike të komunës, përmes integritit sa më të mirë në procesin buxhetor.

Korniza afatmesme buxhetore komunale bazohet në parashikimet e mundshme reale të të hyrave të planifikuara për periudhën afatmesme buxhetore: granteve qeveritare në formë të kufijve buxhetorë, parashikimet mbi trendin e të hyrave vetanake si dhe parashikimeve mbi donacionet e mundshme, qoftë edhe në formë të participimeve të qytetarëve (grave dhe burrave), si dhe parashikimet reale të shpenzimeve buxhetore nëpër programet komunale që janë në fushën e përgjegjësisë së tyre.

Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale, kërkuar me Qarkoren Buxhetore Komunale 2024/01 të lëshuara nga Ministria e Financave, punës dhe transferëve në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

KAB 2024-2026 paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti vjetor për vitin 2024.

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2024-2026. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB-it komunal dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:

Deklarata e Prioriteteve Afatmesme 2024-2026 nga Strategjia Zhvillimore Komunale

Komuna e Klinës gjendet në pjesën veri – perëndimore të Kosovës, rajoni i Pejës. Është njëra nga komunat e mesme të vendit. Pozita gjeografike që ka i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit. Komuna e Klinës ka gjithsej 54 fshatra. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Komuna e Klinës ka rreth 38,496 banorë (19,303 gra dhe 19,193 burra) të organizuar në 5,843 ekonomi familjare.

Mbi 1,653 biznese (300 biznese që udhëhiqen nga femrat dhe 1, 257 biznese që udhëhiqen nga burrat) operojnë brenda komunës. Bazuar në të dhënat e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, rreth 545 merren me veprimtari tregtare, 573 shërbyese, 237 prodhuese dhe 298 ndërtimore.

Administrata e Komunës së Klinës është e organizuar përreth zyrës qendrore dhe zyrave lokale që ofrojnë shërbime në nivel të komunitetit, nga të cilat një është e vendosur brenda qytetit, duke përfshirë zyrën qendrore dhe, 9 të tilla në fshatra.

Vizioni i mëposhtëm për Komunën e Klinës i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike, ekonomike e sociale në Komunë, bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike që ka zhvilluar komuna, siç janë: Strategjia e Zhvillimit Ekonomik e Komunës së Klinës 2017-2021 , Strategjia e Zhvillimit Ekonomik e Komunës së Klinës 2022-2027 në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2024-2026 të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve bazë të saj, si dhe Qarkoren Buxhetore Komunale 2024/01 të lëshuara nga Ministria e Financave, punës dhe transferëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës .

Vizion i komunës është që Klina do të bëhet një vend ekonomikisht i zhvilluar, ku gratë dhe burrat kanë mundësi të barabarta për të hapur dhe zhvilluar bizneset e tyre, me një administratë komunale efikase në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve, mjedis të pastër dhe atraktiv për të jetuar dhe investuar. Duke pasur për bazë pozitën dhe kushtet gjeografike, prioritet do të jetë zhvillimi i NVM-ve, bujqësisë, turizmit dhe infrastrukturës fizike. Të kemi ngritje dhe përmirësim të cilësisë në arsim, shëndetësi dhe shërbime publike, ku barazia gjinore është prioritet ndërsektorial .

ECURIA E PROCESIT TË DËGJIMEVE PUBLIKE BUXHETORE PËR DRAFT - KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE 2024-2026

Kryetari i Komunës së Klinës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik, duke respektuar UDHËZIMIN ADMINISTRATIV (MAPL) NR. 06/2018 PËR STANDARDET MINIMALE TË KONSULTIMIT PUBLIK NË KOMUNA, ka filluar

procedurën e dëgjimeve buxhetore për DRAFT - KORNIZËN AFATMESME
BUXHETORE 2024-2026 me themelimin e grupit punues, vendim i datës 5 qershor 2023, me
numër protokolli: 05 Nr. 401-18477/2023, me gjithsej katër anëtarë.

Grupi punues me vendim të kryetarit të komunës, ka hartuar planin e brendshëm të
organizimit të debateve me publikun:

TAKIMI I me lokalitetet: Sferkë, Dush, Gremnik, Volljakë, Qupevë e Lartë, Qupevë e Ulët
dhe Përçevë.

Datë: 15.06.2023, ora 17:00, vendi -objekti i shkollës fillore të mesme të ulët "EMIN
DURAKU", në fshatin Sferkë.

TAKIMI II me lokalitetet: Gllarevë, Caravik, Rixhevë dhe Stapanicë.

Datë: 15.06.2023, ora 18:30, vendi – salla e sporteve "JETONI", në fshatin Gllarevë.

TAKIMI III me lokalitetet: Ujmirë, Dush, Gjurgjevik i Madh, Çabiq, Zabërgjë dhe
Dobërdol.

Datë: 15.06.2023, ora 19:30, vendi- objekti i shkollës fillore të mesme të ulët "ALI
KRASNIQI", në fshatin Ujmirë.

TAKIMI IV me lokalitetet: Jashanicë, Pogragjë, Resnik dhe Jelloc.

Datë: 16.06.2023, ora 17:00, vendi-objekti i shkollës fillore të mesme të ulët "TRE
DËSHMORET", në fshatin Jashanicë.

TAKIMI V me lokalitetet: Drenoc, Pjetërq i Epërm, Pjetërq i Ulët dhe Dugajevë.

Datë: 16.06.2023, ora 19:00, vendi- objekti i shkollës fillore të mesme të ulët "ISA
BOLETINI", në fshatin Drenoc.

TAKIMI VI me lokalitetet: Grabanicë, Bokshiq, Dollovë, Qeskovë, Këpuz dhe Rastok.

Datë: 19.06.2023, ora 16:00, vendi -objekti i shkollës fillore të mesme të ulët "AZEM
BEJTA", në fshatin Grabanicë,

TAKIMI VII me lokalitetet: Zajm, Deiq, Paskalicë dhe Polce.

Datë: 19.06.2023, ora 18:00, vendi- objekti i shkollës fillore të mesme të ulët "MOTRAT
QIRIAZI", paralelja në fshatin Zajm.

TAKIMI VIII me lokalitetet: Budisalc, Rudicë, Jagodë, Videjë, Krushevë, Stupë dhe
Nagllavë.

Datë: 20.06.2023, ora 16:00, vendi- objekti i shkollës fillore të mesme të ulët "NËNË
TEREZA", në fshatin Budisalc.

TAKIMI IX me lokalitetet: Zllakuqan, Radulloc, Krushevë e Vogël, Berkovë, Leskoc,
Ranoc, Pataqan, Shtupel, Gjurgjevik i Vogël, Binxhë dhe Grabc.

Datë: 20.06.2023, ora 18:00, vendi -objekti i shkollës fillore të mesme të ulët “ATË SHTJEFËN GJEÇOVI”, në fshatin Zllakuqan.

Si dhe në fund, takimi i mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal Klinë, datë 27 qershor 2023, prej orës 10:00.

Para datës së takimeve, grupi punues ka nxjerrë njoftimet për të gjitha institucionet komunale, qytetarët, OJQ-të, organizatat e biznesit, kryetarët e fshatrave të bashkësive lokale, media dhe të interesuarit tjerë për pjesëmarrje në këtë takim, si dhe pjesëmarrjen me kërkesa dhe sugjerime në mënyrë elektronike te zyrtarët:

1. Ahmet Berisha, email: ahmet.berisha@rks-gov.net
2. Vlora Tafili, email: vlora.tafili@rks-gov.net

Gjithashtu dhe mundësinë e dorëzimit të propozimeve lidhur me këto akte me shkrim në shërbimin për punë të kuvendit, kati I, zyra e dytë.

Përveç takimit me publikun nëpër lokalitete dhe në sallën e Kuvendit Komunal, grupi punues ka shfrytëzuar metodën për konsultim me qytetarët prej 30 ditësh në ueb-faqen zyrtare të komunës dhe në platformën e konsultimit publik në nivel të qeverisë.

Komuna Klinë: <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2023/05/image.pdf>

Platformën e konsultimeve publike – Qeveria e Kosovës: <https://konsultimet.rks-gov.net/meetings.php?InstitutionID=20514&OpenPage=0&ClosedPage=0>

Materiali në formë fizike iu është mundësuar të gjithë të interesuarve të merret në Zyrën e Shërbimit për Punë të Kuvendit. Po ashtu, ka qenë i publikuar edhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Klinës si dhe në Platformën e Qeverisë së Kosovës për Konsultime Publike.

<https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2023/06/Draft-Korniza-Afatmesme-Buxhetore-2024-2026.pdf>

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime
1. Takim i drejtpërdrejtë në fshatin Sferkë,objekti i shkollës fillore të	15.06.2023 1 orë e 17 min	22 pjesëmarrës	5 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.

mesme të ulët “EMIN DURAKU”, me lokalitetet: Sferkë, Dush, Gremnik, Volljakë, Qupevë e Lartë, Qupevë e Ulët dhe Përçevë.			
2. Takim i drejtpërdrejtë në fshatin Gllarevë, vendi – salla e sporteve “JETONI”, me lokalitetet: Gllarevë, Caravik, Rixhevë dhe Stapanicë.	15.06.2023 1 orë e 6 min	11 pjesëmarrës	7 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.
3. Takim i drejtpërdrejtë në fshatin Ujmirë, vendi- objekti i shkollës fillore të mesme të ulët “ALI KRASNIQI”, me lokalitetet: Ujmirë, Dush, Gjurgjevik i Madh, Çabiq, Zabergjë dhe Dobërdol.	15.06.2023 36 min	15 pjesëmarrës	4 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.
4. Takim i drejtpërdrejtë në fshatin Jashanicë, vendi- objekti i shkollës fillore të mesme të ulët “TRE DËSHMORËT”, me lokalitetet: Jashanicë, Pogragjë, Resnik dhe Jelloc.	16.06.2023 40 min	9 pjesëmarrës	2 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.

5. Takim i drejtpërdrejtë në fshatin Drenoc, vendi objekti i shkollës fillore të mesme të ulët "ISA BOLETINI", me lokalitetet: Drenoc, Pjetërq i Epërm, Pjetërq i Ulët dhe Dugajevë.	16.06.2023 1 orë e 35 min	31 pjesëmarrës	7 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.
6. Takim i drejtpërdrejtë në Grabanicë, vendi-objekti i shkollës fillore të mesme të ulët "AZEM BEJTA", me lokalitetet: Grabanicë, Bokshiq, Dollovë, Qeskovë, Këpuz dhe Rastok.	19.06.2023 1 orë e 13 min	19 pjesëmarrës	3 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.
7. Takim i drejtpërdrejtë në Zajm, vendi - objekti i shkollës fillore të mesme të ulët "MOTRAT QIRIAZI", me lokalitetet: Zajm, Deiq, Paskalicë dhe Polce.	19.06.2023 27 min	11 pjesëmarrës	1 pjesëmarrës ka parashtruar kërkesa.
8. Takim i drejtpërdrejtë në Budisalc, vendi-objekti i shkollës fillore të mesme të ulët "NËNË TEREZA", me lokalitetet: Budisalc, Rudicë, Jagodë, Videjë, Krushevë, Stupë dhe	20.06.2023 38 min	17 pjesëmarrës	4 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.

Nagllavë.			
9. Takim i drejtpërdrejtë në fshatin Zllakuqan, vendi- objekti i shkollës fillore të mesme të ulët “ATË SHTJEFËN GJEÇOVI”, me lokalitetet: Zllakuqan, Radulloc, Krushevë e Vogël, Berkovë, Leskoc, Ranoc, Pataqan, Shtupel, Gjurgjevik i Vogël, Binxhë dhe Grabc.	20.06.2023 54 min	16 pjesëmarrës	4 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.
10. Takim i drejtpërdrejtë në sallën e Kuvendit Komunal Klinë	27.06.2023 41 min	22 pjesëmarrës	2 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.
11. Publikimi në ueb-faqe / platforma	30 ditë	0 pjesëmarrës	0 kërkesa të parashtruara.

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizike, si dhe ato në formë elektronike janë shqyrtuar nga Grupi Punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Draft –Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026, pas përmbylljes së procesit të konsultimit, do të finalizohen së bashku me komente dhe sugjerimet dhe do të procedohet për në Kuvendin e Komunës së Klinës, për shqyrtim dhe miratim.

Shtojca nr. 1 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara.

Tema e dëgjimit	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Personi i kërkesës / sugjerimi për projektet	Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar , pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mospranimin të komenteve është i detyrueshëm)
TAKIMI I ME LOKALITETET: SFERKË, DUSH, GREMNIK, VOLLJAKË, QUPEVË E LARTË, QUPEVË E ULËT DHE PËRÇEVË				
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkesë për uji të pijshëm dhe për amvisëri. Kërkesë, po ashtu, për sanim të rrugës dhe asfaltim të rrugëve në lokalitetin ku jeton.	Haki Gashi – Fshati Volljakë.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Haki Gashi nga fshati Volljakë, pasi ka kontratë aktive për rinovim të rrugëve
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkesë për asfaltimin e rrugicës e cila ka mbetur në gjysmë ose shtrim me kubëza.	Vehbi Gashi – Fshati Sferkë.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Vehbi Gashi nga fshati Sferkë, hyn prioritet në vitet 2024-2026.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkon që të investohet në ndriçim publik dhe rrjeti energjetik të rregullohet.	Rilind Gashi – Fshati Sferkë.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Rilind Gashi, hyn prioritet në vitet

	Gjithashtu edhe rregullimi e kompleksit memorial të fshatit Sferkë.			2024-2026.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkesë që të kthesa Gremnik-Prishtinë të krijohet një rreth për të lehtësuar rrezikshmërinë në komunikacion.	Binak Gashi – Fshati Sferkë.	Refuzohet	Përgjigja: Grupi punues ka refuzuar kërkesën e z. Binak Gashi nga fshati Sferkë, për arsye se kjo çështje i takon Qeverisë apo më saktë Ministrisë së Infrastrukturës, sepse është zonë që udhëhiqet nga Ministria e Linjës.
	Kërkon kanal të hapur që të lehtësojë rrjedhën e ujit dhe të bëjë grumbullimin e ujërave atmosferike, gjithashtu ndriçim publik dhe investime në rrjetin e KEDS.	Demë Kalludra – Fshati Gremnik.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Demë Kalludra, pasi kanali i ujitjes është projekt i planifikuar nga komuna dhe do të implementohet këtë vit. Sa i përket rrymës, do të zhvillojmë edhe një takim me KEDS-in për rregullimin e rrjetit energjetik,
TAKIMI II ME LOKALITETET: GLLAREVË, CARAVIK, RIXHEVË DHE STAPANICË				
DRAFT - KORNIZA AFATMESME	Kërkesë që të ndërtohet rrjeti i kanalizimit në	Xhevdet Balaj - Fshati Gllarevë.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka

BUXHETORE 2024-2026	një pjesë të fshatit.			pranuar kërkesën e z. Xhevdet Balaj nga fshati Gllarevë, hyn prioritet në vitet 2024-2026.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkon të rregullohet një prerje e asfaltit nga ndërtimi i kanalizimit, rruga ka filluar të shembet për shkak të prerjes.	Tafil Morina, lagjja "Manaj" – Fshati Gllarevë.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Tafil Morina nga fshati Gllarevë, lagjja "Manaj", e cila do të marrë kontratën për mirëmbajtjen e rrugëve në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkesë për asfaltim të rrugës që shpie te shtëpia e tij.	Alban Balaj – Fshati Gllarevë.	Refuzohet	Përgjigja: Grupi punues ka refuzuar kërkesën e z. Alban Balaj, pasi që në Gllarevë do të implementohen dy projekte të mëdha dhe investimet janë orientuar në rrjet të kanalizimit dhe kanal të ujitjes.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkon që tri rrugët e lagjes së tij të asfaltohen: rruga "17 shkurti", rruga "Hisen Bashota" dhe rruga e tretë degëzim nga	Fadil Bashota – Fshati Caravik.	Pranohen	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Fadil Bashota nga fshati Caravik, hyjnë si prioritete në vitet në vazhdim.

	rruga e dytë, për në Stapanicë. Po ashtu, kërkon një fushë të futbollit dhe gjelbërim të hapësirave publike, dhe shpreh vullnetin që me fonde vetanake të punojë hapësirat publike. Gjithashtu, kërkon një trotuar për këmbësorë, përgjatë rrugës “17 Shkurti”.			
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkon të rregullohet ujësjellësi në fshatin Gllarevë.	Emin Balaj – Fshati Gllarevë.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Emin Balaj nga fshati Gllarevë, pasi është në fazën e realizimit me projektin e CDI.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkon ndërtimin e një parku në fshatin Gllarevë.	Skender Veselaj – Fshati Gllarevë.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Skender Veselaj nga fshati Gllarevë, pasi që tani komuna e Klinës ka kontratë për ndërtimin e parqeve nëpër fshatra.

DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkon t'i asfaltohet rruga pranë shtëpive të tij në fshatin Gllarevë.	Shaip Veselaj – Fshati Gllarevë.	Refuzohet	Përgjigja: Grupi punues ka refuzuar kërkesën e z. Shaip Veselaj, pasi që në Gllarevë do të implementohen dy projekte të mëdha dhe investimet janë orientuar në rrjet të kanalizimit.
---	--	--	------------------	--

**TAKIMI III ME LOKALITETET: UJMIRË, DUSH, GJURGJEVIK I MADH, ÇABIQ, ZABËRGJË
DHE DOBËRDOL**

DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkon ndriçim publik sa i përket rrugës kryesore Çabiq - Zabërgjë, si dhe disa zona të degëzuara nga rruga kryesore.	Sokol Krasniqi – Fshati Çabiq.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Sokol Krasniqi nga fshati Çabiq, pasi tashmë janë ndarë mjetet për ndriçim publik.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkesë për rregullimin e rrugës me zhavorr ose asfalt sepse është e vështirë për t'u kaluar, 800 metra janë për t'u shtruar nga drejtimi për Gllarevë.	Sejdi Hodaj - Fshati Zabërgjë.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Sejdi Hodaj nga shati Zabërgjë, pasi komuna e Klinës ka kontratë aktive për shtrim të rrugëve me zhavorr.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkon rinovim të rrjetit të KEDS-it, si dhe asfaltimin e rrugës te	Fatmir Millaku - Fshati Ujmirë.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Fatmir Millaku nga shati Ujmirë, pasi që

	ambulanca, që është afro 30-40 metra.			ky fshat është i përfshirë në investimet e rregullimit të tensionit të rrymës nga KEDS. Gjithashtu edhe asfaltimi i rrugës të ambulanca e fshatit.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkon që në pjesën ku hidhen mbeturinat inerte, të rrafshohet zona me mbeturina, dhe me vullnet të tij dëshiron të investojë në hapësirë të gjelbër me pemë dekorative dhe kërkon që edhe komuna ta ndihmojë me rrafshim të zonës dhe me zhavorr.	Ukë Gashi – Fshati Ujmirë.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Ukë Gashi nga fshati Ujmirë, hyn prioritet në vitet 2024-2026.
TAKIMI IV ME LOKALITETET: JASHANICË, POGRAGJË, RESNIK DHE JELLOC				
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkon shtrimin e një rrugice 70 metra në fshatin Dush, lagjja “Sejdiu”. Po ashtu, kërkon të bëhet	Masar Marmullaku – Fshati Dush.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Masar Marmullaku nga fshati Dush, hyn prioritet në vitet

	ndriçimi publik në fshatin Dush.			2024-2026.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkon zgjerimin e shtrirjes së ujit të pijes në fshatin Jelloc dhe Resnik.	Liridon Racaj – Fshati Jelloc.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Liridon Racaj nga fshati Jelloc, hyn prioritet në vitet 2024-2026.
TAKIMI V ME LOKALITETET: DRENOC, PJETËRQ I EPËRM, PJETËRQ I ULËT DHE DUGAJEVË				
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkon ujë të pijes, ndriçim dhe 1.5 km kanalizim, po ashtu 1.5 km asfaltim. Thekson se varrezat dhe lumi janë një ndër sfidat e lokalitetit Drenoc, ku së fundmi lumi ka dalë nga shtrati duke bërë dëme nëpër fushat e tyre.	Halil Avdiu - Përfaqësues i fshatit Drenoc.	Pjesërisht Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar pjesërisht kërkesën e z. Halil Avdiu, si përfaqësues i fshatit Drenoc, hyjnë në prioritet në vitet 2024-2026.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	1. Kërkon asfaltimin e rrugës nga shkolla e fshatit, deri te rruga “Ramë Jagoda”, me gjatësi afër	Ismet Jagoda – Përfaqësues i fshatit Pjetërq i Epërm.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar pjesërisht kërkesën e z. Ismet Jagoda, si përfaqësues i fshatit Pjetërq i Epërm,

	300 metra. 2. Trotuar nga rruga magjistrale e deri në qendër të fshatit për fëmijët që shkojnë në shkollë. 3. Ndriçimi është i dëmtuar në disa lagje, kërkon të rregullohet. 4. Asfaltimi i rrugës tek banori Smajl Haxhia.			hyjnë në prioritet në vitet 2024-2026.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkon asfaltimin e rrugës për te varrezat, dy rrugë fushore në total 1100 metra si dhe ndriçimi të bëhet në disa lagje të fshatit Pjetërq i Ulët.	Skender Daka - Fshati Pjetërq i Ulët.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z.Skender Daka nga fshati Pjetërq i Ulët, hyn në prioritetet e viteve të ardhshme. Ndërsa rrugët fushore do të kryhen pasi që Drejtoria e Urbanizmit ka ndarë fonde për shtrimin e rrugëve fushore.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkesë të përfshihen në kanalizim disa shtëpi në lagjen "Marku."	Mark Marku - Fshati Drenoc.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z.Mark Marku nga fshati Drenoc, pasi kanalizimi është në projekt dhe do të përfundohet sivjet.

DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkon asfaltimin e një rruge 1000m me drejtim nga Pjetërqi, nga lagja e “Bytyqve”.	Faton Gojani - Fshati Dugajevë.	Refuzohet	Përgjigja: Grupi punues ka refuzuar kërkesën e z.Faton Gojani nga fshati Dugajevë, pasi që në këto lokalitete janë bërë tejet investime dhe ajo rrugë nuk është rrugë kryesore që lidh lokalitetet.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkon shtrimin e rrugëve fushore në Drenoc.	Avni Avdyli - Fshati Drenoc.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka refuzuar kërkesën e z. Avni Avdyli nga fshati Drenoc,rrugët fushore do të kryhen pasi që Drejtoria e Urbanizmit ka ndarë fonde për shtrimin e rrugëve fushore.
KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkon shtrirjen e rrjetit te ndriçimit në Drenoc.	Shaqir Fejza – Fshati Drenoc.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z.Shaqir Fejza nga fshati Drenoc, pasi do të bëhet zgjerimi i rrjetit në fshatrat e komunës së Klinës.
TAKIMI VI ME LOKALITETET: GRABANICË, BOKSHIQ, DOLLOVË, QESKOVË, KËPUZ DHE RASTOK				
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkesë për investime në shtylla elektrike, pasi në disa lagje është	Qazim Berisha – Fshati Grabanicë.	Refuzohet	Përgjigja: Grupi punues ka refuzuar kërkesën e z. Qazim Berisha, pasi që nuk mund të

	dëmtuar.			ndërhyhet në sistemin e tensionit të KEDS, por që gjithsesi do të bëhet përpjekje që të kontaktohet KEDS dhe të shikohen mundësitë për bashkëpunim dhe bashkëfinancim.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkon një rrugë fushore në drejtim nga Bistrica, po ashtu edhe ndriçim në disa lagje.	Gjevdet Berisha – Fshati Këpuz.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka refuzuar kërkesën e z. Gjevdet Berisha nga fshati Këpuz, pasi rrugët fushore do të kryhen sepse Drejtoria e Urbanizmit ka ndarë fonde për shtrimin e rrugëve fushore. Gjithashtu ndriçimi do të realizohet në Drejtoria e Shërbimeve Publike.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkon rinovim në kanalin e ujitjes sepse është i dëmtuar dhe ka vështirësi në përdorim.	Kastriot Arifi – Fshati Grabanicë.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Kastriot Arifi nga fshati Grabanicë, pasi ky projekt është duke u implementuar ende.
TAKIMI VII ME LOKALITETET: ZAJM, DEIQ, PASKALICË DHE POLCE				
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE	Kërkon shtrirje të kanalizimit tek lagja “Ferat Thaqi”.	Mete Krasniqi – Fshati Zajm.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z.

2024-2026				Mete Krasniqi nga fshati Zajm, pasi që pritet të realizohet brenda këtij viti.
TAKIMI VIII ME LOKALITETET: BUDISALC, RUDICË, JAGODË, VIDEJË, KRUSHEVË, STUPË DHE NAGLLAVË				
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkon projektin e ujit të pijshëm.	Halil Ahmetgjekaj – Fshati Rudicë.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Halil Ahmetgjekaj nga fshati Rudicë, pasi rrjeti i ujësjellësit është duke u implementuar me CDI-në.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkon të bëhen më shumë pendë për ujitje.	Rrustem Imeri – Fshati Rudicë.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Rrustem Imeri nga fshati Rudicë, që të jetë pjesë e KAB-it për vitet 2024-2026, pasi kjo kërkesë e tillë ishte e më shumë se tre banorëve në takimin me publikun në Budisalc.
TAKIMI IX ME LOKALITETET: ZLLAKUQAN, RADULLOC, KRUSHEVË E VOGËL, BERKOVË, LESKOC, RANOC, PATAQAN, SHTUPEL, GJURGJEVIK I VOGËL, BINXHË DHE GRABC				
DRAFT - KORNIZA AFATMESME	Kërkesë për rinovimin e shkollës në	Kristina Lazri – Fshati Zllakuqan.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e

BUXHETORE 2024-2026	fshatin Zllakuqan.			znj. Kristina Lazri nga fshati Zllakuqan, pasi komuna e Klinës është në fazën e prokurimit publik. Njoftimin për kontratë “Rinovime në Shkolla”, me gjithsej pesë lote.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkohe rinovimi i rrugës kryesore.	Kolë Rrapi – Fshati Ranoc.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Kolë Rrapi nga fshati Ranoc, pasi që në atë pjesë të lokalitetit është duke u implementuar kontrata për rinovim të rrugëve.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkon një rrugë fushore që të shtrohet me zhavorr, sepse gjendja është e rëndë.	Lukë Gjoka – Fshati Zllakuqan.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Lukë Gjoka nga fshati Zllakuqan, pasi që Drejtoria e Shërbimeve Publike ka ndarë fonde për shtrimin e rrugëve me zhavorr.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkon që të vendosen dy policë të vdekur në rrugë afër shkollës, sepse e konsideron që ka rrezik nga shpejtësia e lartë.	Nue Balaj – Fshati Budisalc.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka refuzuar kërkesën e z. Nue Balaj nga fshati Budisalc, pasi që Drejtoria e Inspektoratit ka kontratë aktive për sinjalizim dhe shenjëzim.

DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkohet kyçja në rrugë në Pataqan dhe Radulloc.	Gustin Tomaj – Fshati Pataqan.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z.Gustin Tomaj nga shati Pataqan, pasi që në atë pjesë të lokalitetit është duke u implementuar kontrata për rinovim të rrugëve dhe do t'i shtohet një pjesë nga kjo kontratë për kyçje.
DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkohet kanal të ujitjes, 750 metra të shtrohet me beton.	Halil Mehmetaj – Lokaliteti Budisalc.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Halil Mehmetaj nga lokaliteti Budisalc, pasi ky projekt është pjesë e KAB-it 2024-2026.

TAKIM I DREJTPËRDREJTË NË SALLËN E KUVENDIT KOMUNAL KLINË

DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkohet rregullimi i shtratit të lumit “Bistrice”.	Zenun Zeqa – Fshati Bokshiq.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Zenun Zeqa nga fshati Bokshiq, pasi komuna e Klinës ka pësuar dëme të mëdha nga vërshimet, investimet do të orientohen tek rregullimi i shtretërve të lumenjve.
---	--	------------------------------------	-----------------	--

DRAFT - KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026	Kërkohe rregullimi i shtratit të lumit "Drini".	Muhamet Foniqi-Fshati Zajm.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Muhamet Foniqi nga fshati Zajm, pasi komuna e Klinës ka pësuar dëme të mëdha nga vërshimet, investimet do të orientohen tek rregullimi i shtretërve të lumenjve.
---	--	-----------------------------------	----------	---

Gjatë debateve buxhetore për Draft – Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026, pjesëmarrës kanë qenë 173 persona.

Shtojca Nr. 2 – Tabela e numrit të pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Femra	13
Meshkuj	160
Total:	173

Kryesuesja e grupit punues
Melihate Behramaj

Klinë, 30.06.2023

